

LEDIA DUSHKU, EDON QESARI

Instituti i Historisë/Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë
ledia.dushku@asa.edu.al/edon.qesari@asa.edu.al

**NGA ANOJNË ARBËRESHËT? DILEMAT E VJENËS
KUNDREJT POLITIKËS ITALIANE DHE NACIONALIZMIT
ITALO-SHQIPTAR NË PRAG TË SHEK. XX****Abstrakt:**

Artikulli synon të japë një panoramë të veprimtarisë së arbëreshëve në periudhën kur në Vjenë bëheshin përgatitje, zhvilloheshin bisedime për të vënë në zbatim politikën që do të duhej të ndiqnin ndaj shqiptarëve dhe çështjes së tyre kombëtare. Bëhet fjalë për vitet 1895-1897, dy vite intensive, me zhvillime në Ballkan dhe veprimtari të zëshme të arbëreshëve të Italisë, ku ndikimi i Romës zyrtare mbetet i lartë. Artikulli ka si qëllim të zbulojë arsyet e formësimit të vëmendjes austro-hungareze ndaj arbëreshëve të Italisë: të analizojë linjat e veprimtarisë së arbëreshëve, duke evidentuar mjetet që ata përdorën; ndikimin që kjo veprimtari pati në përshtatjen e objektivave të politikës austro-hungareze në lidhje me Italinë dhe shqiptarët, dhe në një analizë tërësore për të sjellë në vëmendjen e lexuesit dilemat e Vjenës në lidhje me nacionalizmin e italo-shqiptarëve në prag të shek. XX.

Fjalë kyçe:

Arbëreshë/italo-shqiptarë, diasporë, Jeronim de Rada, Anselmo Lorecchio, shqiptarë, Austro-Hungaria, Italia, Francesco Crispi, *status quo*.

Hyrje

Bashkimi i Gjermanisë në vitin 1871, nëpërmjet së ashtuquajturës “Rrugëzgjidhje e vogël gjermane” (Kleindeutsche Lösung) mandej, shkëputja nga kjo e fundit e territoreve italianofone në Lombardi dhe

Venedik, si edhe fuqizimi i hegjemonisë ruse në lindje të Europës, gjykohen si rrethanat parësore, që shpjegojnë vëmendjen e përqendruar të politikës së jashtme të Austro-Hungarisë në gadishullin e Ballkanit.¹ Vijimisht, synimi për të mos ia lënë Italisë përparësinë në rajon, si dhe antagonizmi me Rusinë, u shoqëruan me rishikimin e herëpashershëm të politikës së jashtme vjeneze ndaj Ballkanit, që kishte mbetur tashmë i vetmi rajon në të cilin Monarkia Dualiste mund të matej me Fuqitë e tjera të Mëdha. Kësisoj, në një sistem të sofistikuar gjeostrategjik që përfshinte krejt gadishullin, trevat e banuara nga shqiptarë u konsideruan zonë ndikimi - ndoshta më të rëndësishmet, në vazhden e këtij këndvështrimi - për Ostpolitik-ën habsburgase. Rreth 90 km larg bregdetit italian, ato treva, në përlllogaritjet habsburgase, shërbenin së paku për dy arsye: parandalonin Italinë që synonte hegjemoninë mbi zonat bregdetare adriatike, pjesë e Ballkanit të mbetur në duart osmane; shërbenin si zonë tampon, në saje të të qenit një mburojë territoriale përkundër shtytjes sllave, e për rrjedhojë ruse, në rrafshin kontinental ballkanik, që Porta e Lartë zor se mund ta kontrollonte edhe për shumë kohë.² Nisur nga këto rrethana, vëmendja ndaj shqiptarëve dhe prania e gjithfarshme austro-hungareze në institucionet fetare katolike, ato arsimore, ekonomike, si dhe kulturore në hapësirën osmane, u bënë shtylla bazë të politikës habsburgase në procesin e stabilizimit të ndikimit të tyre në Adriatik.

¹ Për një trajtim të thelluar mbi politikën e jashtme ballkanike të Monarkisë Dualiste, shih: Kurt Gostentschnigg, “Qëndrimet e Austro-Hungarisë ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në kontekstin e marrëdhënieve të përgjithshme austro-shqiptare”, *Shqipëri - Austri: reflektim historiografik* (Aktet e Konferencave Shkencore: Shkodër, maj 2012 - Tiranë, tetor 2012) përgatitur për botim nga Ardian Marashi dhe Albert Rakipi (Tiranë: Botimet Albanologjike, 2013) 39-47; Kurt Gostentschnigg, Karl Kaser “Albanologjia austro-hungareze 1867-1918 - një rast i imperializmit kulturor? Një projekt kërkimor”, *Hylli i Dritës*, Vjeti XXXIV, nr. 1-2, (2014), 3-8; Kurt Gostentschnigg, *Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär. Die österreichisch – ungarische Albanologie 1867-1918* (Wiesbaden: Springer VS, 2018), 263-377; Anna Hedwig Benna, “Studien zum Kultusprotektorat Österreich-Ungarns in Albanien im Zeitalter des Imperialismus (1888-1918)”, *Mitteilungen des Österreichischen Staatsarchivs, Herausgegeben von der generaldirektion*, no. 7 (1954), 13-26.

² Edon Qesari, “Shqiponja e përçarë: Përplasja italo-habsburgase për çështjen shqiptare mes fundshekullit XIX dhe fillimshkullit XX”, *Shqipëri - Austri: reflektim historiografik...*, 98; *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. I, botim i Institutit të Historisë / ASA, (Tiranë: Kristalina-KH, 2017), 164.

Nga 17 nëntori deri më 23 dhjetor 1896, në Vjenë u zhvilluan tri konferenca të fshehta nën drejtimin e ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, kontit Goluchowski, të cilat mbështetën fillimin e një aksioni të gjithanshëm në Shqipëri (*Aktion in Albanien*), i cili madje nuk përjashtonte as ndërhyrjen ushtarake. Studiuesja Teodora Toleva ndan mendimin se pjesa taktike e këtij aksioni mëtonte zgjedhjen dhe përdorimin efikas të mjeteve sa më të përshtatshme për të arritur qëllime të caktuara politike, siç ishin “përhapja e idesë së kombit mes fiseve shqiptare me besime të ndryshme fetare, puna me klerin katolik për të fituar mbështetjen e tij, themelimi i një gjuhe të unifikuar dhe promovimi i saj, hapja e shkollave shqiptare, hartimi dhe shpërndarja e librave dhe revistave me përmbajtje nacionaliste”.³

Monarkia Dualiste synonte kështu të ndikonte mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, duke e kthyer atë në *protégé*-n e saj; ndërmarrje kjo e fundit, që u rivalizua fuqimisht nga Mbretëria e Italisë. Ngase, përtej detyrimeve që rridhnin nga prania në të njëjtën aleancë me Vjenën,⁴ Roma zyrtare filloi të tregojë dallueshëm interes për çështjet ballkanike, e më konkretisht për atë shqiptare, mbas disfatës ushtarake në Adua të Etiopisë, më 1896,⁵ pikërisht atëherë kur Austro-Hungaria e kishte konsoliduar deri diku pozitën e saj në Adriatikon osman, posaçërisht ndër popullsinë katolike të vilajetit të Shkodrës.⁶ Përkundrejt Vjenës, Roma i vlerësonte shqiptarët si kundërpeshë ndaj sprovës hegjemoniste të habsburgasve në Adriatik, e afërmendsh për të rritur, në këmbim, ndikimin vetjak në atë zonë. Porse, me kalimin e viteve, Roma

³ Për një trajtim të thelluar të konferencave të organizuara dhe Memorandumit për Shqipërinë (*Mémoire über Albanien*) shih: Teodora Toleva, *Influenca e Perandorisë Austro-Hungareze në ndërtimin e kombit shqiptar 1896-1908*, përkth. Admira Nushi (Tiranë: Dudaj, 2018), 38-81.

⁴ Vlen të përmendet se Italia, bashkë me Austro-Hungarinë, ishin pjesëmarrëse në Aleancën Tripalëshe. Për më shumë, shih literaturën e parë në referencën nr. 2.

⁵ Ennio Maserati, *Momenti della questione adriatica*, (Verona: Del Bianco Editore, 1981), 34; Maurizio Vernassa, “Opinione pubblica e politica estera. L’interessamento italiano nei confronti dell’area balcanica. 1897-1903”, *Rassegna storica del Risorgimento*, anno LXIII, no. 3, (1976), 339.

⁶ Për më tepër, shih: K. Gostentschnigg, *Wissenschaft im Spannungsfeld...*, 263-377. Interesant mbetet pohimi i Stavro Skëndit, sipas të cilit vetë procesi i islamizimit të këtyre popullatave nga ana e Portës së Lartë, mes të tjerash, kishte për synim pikërisht kundërvënien ndaj shtrirjes së ndikimit austriak në gjirin e katolikëve vendës. Stavro Skendi, “Religion in Albania during the Ottoman Rule”, *Süd-Öst Forschungen*, vol. XV, (1956), 315-318.

bindej se çdo përparim i saj në pjesën perëndimore të vilajeteve të Rumelisë - ashtu si edhe vetë qasja e shqiptarëve drejt vetëvendosjes politike - do të mund të shndërroheshin në realitet vetëm pas një marrëveshjeje të qartë, por edhe më të drejtpërdrejtë se ç'ishte bërë deri atëherë, me Vjenën.⁷

Në të tilla zhvillime, shqetësimi se mes Italisë dhe Austro-Hungarisë mund të rrëshqitej kollajshëm nga aleanca në përplasje luftarake, nuk rezultoi dritëlargët. Ishte nëntori i vitit 1897, kur me marrëveshjen verbale të arritur në Monza,⁸ pavarësisht dyshimeve të ndërsjella dhe kontradiktave, dy kundërshtarët zgjodhën bashkërendimin, me qëllimin përfundimtar për të vendosur ekuilibrin mes tyre në Adriatik, duke ruajtur kësisoj mundësinë për të mbajtur një sy hapur ndaj njëri-tjetrit. Në Monza u arrit në këtë mënyrë ujdia historike pa dëmtuar interesat e të dy Fuqive të Adriatikut në territoret e shqiptarëve përmes ruajtjes së *status quo*-së; ndonëse palët e skiconin këtë gjendje nisur nga këndvështrimet e ndryshme që kishin për situatën gjeopolitike dhe gjeostrategjike në tërësi.⁹ Nëse imponohej tjetërsimi, palët do të bënin përpjekje që

⁷ *I Documenti Diplomatici Italiani* (më tej: *DDI*), Terza serie: 1896-1907, vol. II (1 maggio 1897-23 giugno 1898), Ministero degli Affari Esteri, (Roma: Istituto Poligrafico dello Stato P.V, 1958), dok. nr. 251. Raport i A. Baldacci-t për ministrin italian të Punëve të Jashtme, Bolonja, 27 tetor 1897; *po aty*, dok. nr. 379. Raport i konsullit italian në Janinë, Millelire, për ministrin e Punëve të Jashtme, Visconti Venosta, Janinë, 21 shkurt 1898.

⁸ Takimi në Monza, si dhe përfundimet e atjeshme, mes ministrit të Jashtëm italian Visconti Venosta dhe homologut të tij austro-hungarez Goluchowski, nuk u pasuan nga hartimi i një deklaratë zyrtare të përbashkët. Në botimin e serisë së Dokumenteve Diplomatike Italiane shënohet: “Me gjithë kërkimet e kryera në arkivat e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe në dokumentet e Arkivit Visconti Venosta, procesverbal i takimit të Monzës ndërmjet ministrit Visconti Venosta dhe Goluchowski nuk është gjetur, nuk është gjetur as ndonjë dokument i kohës që i referohet vetë bisedave”. (*DDI*, Terza serie, II, dok. nr. 215); Më shumë të dhëna jep qarkorja që Goluchowski i dërgoi vartësve të tij, e cila iu bë me dije “në mënyrë tejet konfidenciale”, edhe ambasadorit italian në Berlin, Lanza. Ky i fundit, paskëtaj, ia kaloi atë eprorit në Romë. *DDI*, Terza serie, II, dok. nr. 286, 27 nëntor 1897. (Përkthimi i pasazheve këtu dhe më tej është kryer nga E. Qesari.)

⁹ Për Vjenën *status quo*-ja shërbente për ta vonuar sa më shumë çastin fatal të shpërbërjes së Perandorisë Osmane, në të cilin Mbretëria Dualiste do të gjendej e vetme përpara një vërshimi të mundshëm sllav pa ndihmën e një strukture shtetërore formale siç ishte Perandoria Osmane. Për një shtjellim më të gjerë, shih: E. Qesari, “Shqiponja e përçarë: Përplasja italo-habsburgase për çështjen shqiptare...”, 101-105.

ndryshimet relative të shkonin në drejtim të autonomisë,¹⁰ duke mbështetur ngritjen e një entiteti të bashkuar shqiptar brenda suzerenitetit osman, ndërkohë që angazhoheshin të kërkonin dhe të përdornin rrugë dhe “mjetet më të përshtatshme për të gjetur një ujdi mes interesave tona [nënkupto interesa austro-italiane] përkatëse, si dhe për t’i mbikëqyrur ato”.¹¹ Tërvat ku jetonin shqiptarët mbeteshin kështu, qoftë edhe vetëm *de jure*, nën varësinë e Sulltanit për sa kohë Perandoria Osmane do të ekzistonte. Deri në nëntor të 1912-s, kjo shërbeu si themel jo vetëm i marrëveshjeve bilaterale, por edhe i vetë Aleancës së Trefishtë, ndonëse Italia gjykohej nga Austro-Hungaria dhe Gjermania si aleat i luhatsëm, e cila mund të tundohej nga mundësia e bashkëpunimit me kundërshtarët e tyre, Francën, Britaninë e Madhe dhe Rusinë, të grumbulluara që nga viti 1907 nën siglën e Antantës.

1. Në kontekstin e kësaj marrëdhënieje sa dinamike aq edhe të turbullt skicohet edhe vëmendja e posaçme e Austro-Hungarisë për arbëreshët e Italisë - ndryshe italo-shqiptarët, togfjalëshi identifikues për këtë grup - që haset në dokumentacionin arkivor të Mbretërisë Dualiste. Ky komunitet do të jetë njëri nga faktorët trajtësues jo vetëm të nacionalizmit shqiptar, por edhe të veprimtarisë vetëvendosëse ndaj pushtetit osman. Edhe më interesant është ndikimi që rrethet arbëreshe patën në politikën ballkanike të Italisë në fund të shek. XIX, kur personalitete italo-shqiptare ushtruan jo pak autoritet në këtë drejtim. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë për peshën që pati Francesco Crispi, i cili, më shumë se kushdo, u orvat për një prani të fuqishme italiane në çështjen shqiptare, e kryesisht në parandalimin e depërtimit në të, të Fuqive të

¹⁰ E. Walters, “Austro-Russian Relations under Goluchowski 1895-1906”, *The Slavonic and East European Review*, vol. XXXI, no. 76 (1952), 188.

¹¹ *I Documenti Diplomatici Italiani*, Terza serie, vol. III (24 giugno 1898-25 luglio 1900), (Roma: Istituto Poligrafico dello Stato P.V, 1962), dok. nr. 404. Visconti Venosta për ambasadorin italian në Vjenë, Nigra, Romë, 24 maj 1900; shih edhe: *DDI*, Terza serie, II, (shënimi 2, f. 215), dok. 286. Ambasadori italian në Berlin, Lanza për ministrin e Punëve të Jashtme, Visconti Venosta, Berlin, 27 nëntor 1897; Zef Prela, “Problemi shqiptar dhe politika austro-hungareze (1897-1912)”, *Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare (përmbledhje studimesh kushtuar 50-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë)*, (Tiranë: Mihal Duri, 1961), 112, 115; Gaetano Salvemini, *La politica estera dell’Italia dal 1871 al 1914* (Firenze: Barbera Edition, 1944), 114-115.

tjera të Mëdha.¹² Austro-hungarezët madje mendonin se ishte pikërisht kryeministri arbëresh i Italisë ai i cili, qysh në fund të viteve 1870, i kishte shtyrë italo-shqiptarët të ndërlihdeshin politikisht me çështjet që vlonin në tokën e tyre të origjinës.¹³ E në sytë e Vjenës, ky zell ishte vetëm një manovër për të përshpejtuar procesin e ndikimit italian në territoret e shqiptarëve. Arsyet për të cilat vitet 1895-1897 mund të konsiderohen të rëndësishme në përvijimin e institucionalizuar të interesimit të mësipërm lidhen sa me jetësimin e *Aksionit për Shqipërinë*, aq edhe me përpjekjet për të arritur një kompromis në marrëdhëniet me Italinë, në kushtet e paaftësisë së dukshme të qeverisë osmane për të përmbushur nevojat e popujve të ndryshëm në provincat europiane ende nën skeptrin e saj. Ndërsa pushteti qendror osman dobësohej me ritme të përshpejtua dhe shpërbërja e Perandorisë përfitohej si një ngjarje e mundshme, ndonëse jo e menjëhershme,¹⁴ lëvizjet me prirje shpërndarëse, të nxitura nga lufta greko-osmane e pranverës së 1897-s, tashmë kishin marrë hov. Në atë rast, një “Komitet Politik” arbëresh (*Comitato politico albanese*) do t’i mëshonte pikërisht shembullit të autonomisë që përfitoi ishulli i Kretës në përfundim të konfliktit 30-ditor mes Athinës dhe Portës së Lartë për t’i kërkuar ministrit italian të Punëve të Jashtme, Visconti Venosta, që diplomacia italiane të ndërhynte në mbështetje të një modeli të tillë edhe për shqiptarët në Ballkan.¹⁵

Nuk habit fakti se deri në fund të shekullit, atëherë kur ndërhyrjet arbëreshe nisën të bëheshin gjithnjë e më të shpeshta, edhe vetë kujdesi i Vjenës për të mbledhur sa më shumë të dhëna rreth tyre erdhi duke u

¹² Mbi arbëreshët dhe rolin e tyre në skenën politike italiane, nga ana e historiografisë italiane, shih: Antonio D’Alessandri, “Gli albanesi, l’Adriatico e l’Italia tra fine Ottocento e primo Novecento. L’opera di Anselmo Lorecchio”, *Popoli e culture in dialogo tra il Danubio e l’Adriatico. Contributi italiani al X Congresso Internazionale dell’Associazione Internazionale d’Études du Sud-Est Européen*, Parigi, 24-26 settembre 2009, 79-92; Francesco Caccamo, “L’Adriatico degli arbëreshë: il "mare nostro" albanese e italiano”, *Adriatico contemporaneo: Rotte e percezioni del mare comune tra Ottocento e Novecento*, a cura di S. Trichese e F. Caccamo (Milano: 2008), 123-164.

¹³ Stavro Skëndi, *Zgjidhje kombëtar shqiptar 1878-1912*, përkth. Skënder Luarasi, Nestor Nepravishita (Tiranë: Phoenix & Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 2000), 201.

¹⁴ T. Toleva, *Influenca e Perandorisë Austro-Hungareze ...*, 83. Autorja citon dekretin sekret të datës 18 shkurt 1896 që Ministria e Punëve të Jashtme në Vjenë i dërgon ambasadorit austro-hungarez në Stamboll, baronit Calice.

¹⁵ *DDI, DDI, Terza serie, II*, dok. nr. 290. Komiteti Politik Shqiptar për Visconti Venosta-n, Romë, 30 nëntor 1897.

rritur. Kësodore, një rrjet informatorësh u ngrit në Itali, në saje të veprimtarisë të cilëve në Vjenë mbërritën informacione të detajuara në lidhje me veprimtarinë e arbëreshëve përqendruar në periudhën 1895-1897, kohë kur aktiviteti i tyre la mënjanë ngjyresën individuale apo rivalitetet më të hershme mes krerëve dhe, me organizimin e dy kongreseve linguistike, mori trajtën e një veprimtarie kolektive dhe përbashkuese.¹⁶ Vlen të shtohet se, në të dy këto takime solemne Francesco Crispi zgjidhet president nderi, duke shpallur pothuajse haptas, nga ana e organizatorëve, qëllimin politik që qëndronte pas kongreseve.¹⁷

Pikërisht, në atë kohë konsulli austro-hungarez në Janinë, Julius Pisko konstatoi se “marrëdhëniet e gjalla të arbëreshëve me shqiptarët vlerësohen barabar me rritjen e influencës italiane në Shqipëri...”,¹⁸ ndërkohë që Ministria e Punëve të Jashtme në Vjenë i kërkoi konsullit të Përgjithshëm në Shkodër që të merrte informacione të sakta mbi hollësitë e kësaj lëvizjeje. Kujdesi i këtij të fundit duhej të ishte i plotë “e në bazë të vrojtimeve të deritanishme herë pas here të na relatoni nëse italo-shqiptarët në përgjithësi e sidomos nëse krerët e saj kanë përkrahës në Shqipëri”.¹⁹ Vëmendja intensifikohet dhe merr rëndësi edhe për faktin se më 1895 një kongres me fokus çështjen e unifikimit të alfabetit të shqipes ishte organizuar në Vjenë. Ndërkohë në Ballhausplatz, më 17 nëntor 1896, artikullohet mbështetja që i duhej dhënë arbëreshëve të Zarës, edhe si një nevojë kundërbalancuese e lëvizjes së bashkëkombësve të tyre në Itali. Enkas, në atë takim, një ndër katër planet e veprimit për të ardhmen konsiderohej ngritja e qendrave të veprimit edhe në koloninë shqiptare të

¹⁶ Sipas Stavro Skëndit: “Për shumë vjet me radhë patriotët italo-shqiptarë qenë marrë me veprimtari individuale. Së pari, ata hynë për herë të parë në fushën e një veprimtarie kolektive me dy kongreset linguistike të viteve 1895 dhe 1897. Ndonëse në dukje me karakter linguistik dhe letrar, këto kongrese zbuluan vullnetin e shqiptarëve të Italisë për të marrë pjesë në lëvizjen kombëtare të bashkatdhetarëve të tyre”. S. Skëndi, *Zgjimi kombëtar shqiptar...*, 201-202.

¹⁷ Nuray Bozborra, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, përkth. Dritan Egro (Tiranë: Dituria, 2002), 239.

¹⁸ *Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSSt.A.PA.A*), në *Arkivin e Institutit të Historisë - Tiranë* (më tej: *AIH*), Vj. 6-3. Informacion nga Janina për baronin Julius Zwiedinek në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Janinë, 10 shkurt 1896.

¹⁹ *Po aty*, Vj. 42-5-552. Telegram nga Ministria e Punëve të Jashtme në Vjenë për konsullin e Përgjithshëm Ippen në Shkodër, Vjenë, 14 shkurt 1897.

Zarës, “prej nga ku në Shqipërinë osmane mund të futeshin libra të botuar me mbështetjen e Vjenës, duke mënjanuar çdo lloj dyshimi”.²⁰

2. Dokumentacioni diplomatik vjenez, i viteve 1895-1897, e vë theksin në tri drejtime kryesore: në përvijimin e tipareve të lëvizjes së arbëreshëve të Italisë; mendimin politik të veprimtarëve të dalluar të saj, përqendruar te Jeronim (Girolamo) de Rada dhe Anselmo Lorecchio, si edhe marrëdhënia e tyre me qeverinë italiane.

Të dhënat e përcjella nga terreni për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë e rumbullakosin numrin e përgjithshëm të arbëreshëve në rreth 100 000 frymë, të organizuar në 65 fshatra të provincave jugore italiane: Foggio (Foxhia), Apulia (Apulia), Basilicata (Bazilikata), Cosenza (Kozenca), Calabri (Kalabri) dhe Sicili (Siçili). Përgjithësisht ata vlerësohen si “pasardhës të të ikurve prej Shqipërisë dhe Epirit, pas rënies së dinastisë princore të Gjergj Kastriotit/Skënderbeut në gjysmën e dytë të shek. XV”. Ndërkohë të tjerë ishin vendosur pak më herët në kohën e marshimit që Skënderbeu ndërmori në Apulia në ndihmë të Ferdinandit të Aragonës (1461).²¹

Ndër shekuj arbëreshët e kishin kundërshtuar italianizimin dhe ia kishin dalë mbanë të ruanin veçoritë kombëtare, gjuhën e të parëve, ndonëse huazimet nga italishtja ishin të shumta. Është interesante të vëzhgohet se si konstatime të tilla, që e vënë theksin mbi këmbënguljen e arbëreshëve për ruajtjen e identitetit të tyre etnik, përputhen me politikat e atëhershme dhe të mëvonshme të Vjenës mbi çështjen shqiptare në Ballkan, të angazhuara përmes mekanizmash arsimorë dhe kulturorë, kryesisht në viset veriore, në nxitjen dhe fuqizimin e identitetit etnik shqiptar kundrejt faktorit sllav. Për konsullin austro-hungarez në Janinë, fakti që gjuha dhe zakonet ishin ruajtur për një periudhë më se 400-vjeçare, i dedikohej kompaktësisë kombëtare dhe dokeve të vjetra të trashëguara, të cilat arbëreshët i zotëronin masivisht.²² Duke jetuar në një vend të civilizuar, sikurse Italia, nën frymën dhe ndikimin e

²⁰ T. Toleva, *Influenca e Perandorisë Austro-Hungareze...*, 43.

²¹ *HHSt.A.P.A.A* në *AIH*, Vj. 6-10. Ambasada e Austro-Hungarisë në Itali për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Romë, 1896. Shënime mbi lëvizjen e italo-shqiptarëve në Italinë e Jugut; *po aty*, Vj. 6-95. Raport i konsullit austro-hungarez në Janinë dërguar ministrit të Punëve të Jashtme, kontit Goluchowski, 7 shkurt 1896.

²² *Po aty*, Vj. 6-95. Raport i konsullit austro-hungarez në Janinë dërguar ministrit të Punëve të Jashtme, kontit Goluchowski, 7 shkurt 1896.

Risorgimento-s, ata kishin vlerësuar më herët se vëllezërit e tyre të gjakut, se kushti i parë për vendosjen e një lidhjeje shpirtërore ndërmjet tyre dhe dialekteve të shqiptarëve, ishte krijimi i një alfabeti të unifikuar.²³

Në një qasje të tillë, tipari mbizotërues më i hershëm i lëvizjes së arbëreshëve të Italisë, i identifikuar dukshëm në relacionet e përfaqësuesve diplomatikë habsburgas, ishte ai *linguistik dhe letrar*. Dokumentacioni arkivor austro-hungarez, i konsultuar në këtë artikull, evidenton hapat e ndërmarrë që në vitin 1892 kur Ministria italiane e Arsimit çeli në Shën Mitër (San Demetrio Corone, prefektura e Kozencës) një shkollë për gjuhën shqipe me shpenzime shtetërore. Ky tipar u përforcua me realizimin e dy kongreseve gjuhësore. I pari u mbajt në Corigliano Calabro në tetor të vitit 1895, me nismën e Jeronim de Radës, Giuseppe Schiro-it/Zef Skiroit dhe Anselmo Lorecchio-s. Kongresi themeloi *Shoqërinë Kombëtare Shqiptare* (Società Nazionale Albanese), me qendër po në Shën Mitër, e cila vlerësohej si një institucion me karakter të mirëfilltë linguistik dhe gjuhësor, publik dhe kombëtar, mjaft i dobishëm dhe me një rëndësi historike.²⁴ Pasojë e tij ishte botimi që prej 1 gushtit 1896 e revistës “Stella degli Albanesi”(Ili i Arbëreshëve), e cila përdorte alfabetin e De Radës.²⁵

Kongresi i dytë, vazhdues në të njëjtën linjë me të parin, u mbajt në Lungro (gjithashtu në prefekturën e Kozencës), më 20-21 shkurt 1897. Në të, përveç arbëreshëve të Italisë, morën pjesë edhe disa përfaqësues nga kolonitë e tjera shqiptare, ku dalloheshin ata nga Rumania. Vendimet e tij me natyrë linguistike përqendroheshin në dy drejtime themelore: sigurimi i mjeteve për përpilimin e një fjalori për gjuhën shqipe, për hapjen e një Biblioteke Kombëtare me libra shqip e të huaj, me fokus historinë e shqiptarëve, pa lënë mënjanë edhe botimin e një reviste; koordinimi i punës për përpilimin e bashkësisë së kërkesave, të cilat do t'i drejtoheshin qeverisë italiane, në thelb të të cilave qëndronte krijimi i një katedre të gjuhës shqipe në Institutin Mbretëror Oriental në Napoli, si edhe sigurimi i një subvencionimi vjetor prej 20 000 liretash për Kolegjin e Shën Adrianit në mënyrë që organizimi i tij të zgjerohej me një katedër

²³ *Po aty*.

²⁴ *Po aty*, Vj. 41-1-123. Shoqëria Kombëtare Shqiptare. Listë e anëtarëve themelues, 1895.

²⁵ *Po aty*, Vj. 6-8. Njoftim nga ambasada austro-hungareze në Romë për ministrin e Punëve të Jashtme, 3 tetor 1896.

për greqishten e re dhe një për gjuhën shqipe.²⁶ Njëkohësisht, kongresi zëvendësoi revistën “Ili i Arbëreshëve” me të përdyjavshmen “La Nazione Albanese” (Kombi Shqiptar), si organ të Shoqërisë Kombëtare Shqiptare, e cila do të drejtohej nga Lorecchio.

Nën arsyetimin se nuk mund të kishte diskutime gjuhësore dhe letrare pa diskutime politike, pjesëmarrësit në kongres ndërmorën edhe një përshtatje të statutit: u hoq neni 10, i cili nuk i njihje shoqërisë dhe revistës të drejtën e diskutimeve me natyrë politike.²⁷ Për ambasadën austro-hungareze në Romë, ishte e sigurt se tanimë nën “pretekstin e linguistikës po ndodh një agjitacion politik, që deri tani nuk ka marrë dimensione të mëdha, porse pak e nga pak, po të favorizohet nga qeveria [italiane], mund të zmadhohet e të marrë rëndësi. Shoqëria ia arriti ta zhbëjë nenin 10 të statutit që i ndalon të bëjë politikë, pasi shumë oratorë theksuan dëshirën për të bërë të tyren aspiratat e qytetarëve”.²⁸ Ndryshimi i statutit, vijonte informacioni i dërguar nga Roma, ishte ndikuar edhe nga dalja në skenë e një tjetër shoqate ndër arbëreshët e Italisë.²⁹ Bëhet fjalë për *Komitetin Politik Shqiptar* të Napolit (Comitato Politico Albanese), drejtuar nga markezi Giovanni Castriota Skanderbeg, komitet i cili, në dallim nga *Shoqëria Kombëtare Shqiptare*, ishte ngjizur si shoqëri me natyrë politike, e që kishte si mision “...zhvillimin e marrëdhënieve politike midis Mëmëdheut dhe popullsisë shqiptare të Italisë, duke synuar që të ndihmojë për rimëkëmbjen autonome të Kombit Shqiptar brenda kufijve të tij të natyrshëm...”³⁰

3. Nga sa më sipër angazhimi linguistik e letrar që qartazi manifestonte lëvizja e arbëreshëve të Italisë ishte vetëm njëra anë e medaljes, pasi, sikurse diplomatët austro-hungarezë theksonin “përpjekjet

²⁶ *Po aty*, Vj. 42-3-370. Përcillet një artikull mbi kongresin e dytë gjuhësor nga gazeta “Il Corriere di Napoli”, 4 shkurt 1897; *po aty*, Vj. 42-6-667. Përcillet në Vjenë, numri 4 i revistës “La Nazione Albanese”, 28 shkurt 1897; *po aty*, Vj. 42-5-544. Raport i ambasadës austro-hungareze në Romë për ministrin e Punëve të Jashtme, Romë, 17 prill 1897.

²⁷ *Po aty*, Vj. 42-6-667. Përcillet në Vjenë, numri 4 i revistës “La Nazione Albanese”, 28 shkurt 1897.

²⁸ *Po aty*, Vj. 42-5-548. Raport nga Roma për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, Romë 19 maj 1897.

²⁹ *Po aty*, Vj. 42-5-544. Raport i ambasadorit austro-hungarez në Romë, Passetti për ministrin e Punëve të Jashtme, 17 prill 1897.

³⁰ *Po aty*, Vj. 42-1-161. Statuti i *Komitetit Politik Shqiptar* të Napolit.

e arbëreshëve për sa i përket shkrimit të unifikuar dhe purifikimit të dialekteve shqiptare... ndjekin patjetër edhe tendenca politike”,³¹ “të subvencionuara prej qeverisë italiane”.³² Në këtë mënyrë lëvizja e arbëreshëve bart edhe një tipar të dytë: atë politik, me prirje të qarta nacionaliste, proitaliane dhe antihabsburgase, të cilat, përderisa financoheshin nga Roma, siç dyshonin qarqet diplomatike habsburgase, rrjedhimisht do të përkrahnin interesat e kësaj kundër Vjenës në Shqipërinë osmane. Sipas ambasadës austro-hungareze në Romë, ky tipar del në pah vetëm pas Kongresit të Berlinit (1878), prej ku “kolonitë shqiptare në Italinë e Jugut kanë filluar të lëvizin gjithnjë kur është konstatuar se, situata në Gadishullin Ballkanik kërcënohej të turbullohej në përgjithësi, ose në pjesën lindore të tij”. Çka duket se përputhet plotësisht edhe me dyshimet e kahershme që kishin shprehur vetë qarqet qeveritare italiane rreth përfshirjes së mundshme të arbëreshëve në financimin e veprimtarisë kryengritëse të bashkëkombësve të tyre ndaj vendimeve të Fuqive të Mëdha në kryeqytetin gjerman.³³ Ndonëse nuk ishte në gjendje të paraqiste ndonjë provë, ambasada austro-hungareze, megjithëkëtë, nuk kishte as më të voglin dyshim se prirjet nacionaliste dhe aspiratat e fjetura të asaj kolonie italo-shqiptare i kishte zgjuar Francesco Crispi, me origjinë arbëreshe, në periudhën e mandatit të parë si kryeministër i Italisë (1887-1891).³⁴

Relacionet e përcjella nga Roma, theksonin se nxitja e një lëvizjeje kombëtare e të gjithë shqiptarëve apriori mund të ndodhte vetëm prej kolonive, aty ku shqiptarët zotëronin një shkallë kulture më të lartë, si rrjedhojë e shtysës që vinte nga modelet që transmetonin, shtetet në të cilat ata jetonin. Pikërisht këtu gjendej njëherazi forca e lëvizjes së arbëreshëve të Italisë, por edhe dobësia e saj. Italo-shqiptarët, vijonte arsyetimin ambasada, në të vërtetë ishin italianë, ndërkohë që

³¹ *Po aty*, Vj. 6-95. Raport i konsullit austro-hungarez në Janinë dërguar ministrit të Punëve të Jashtme, kontit Goluchowski, 7 shkurt 1896.

³² *Po aty*, Vj. 6-10. Ambasada e Austro-Hungarisë në Itali për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Romë, 1896. Shënime mbi lëvizjen e italo-shqiptarëve në Italinë e Jugut.

³³ *I Documenti Diplomatici Italiani*, Seconda Serie (1870-1896), vol. 10 (24 marzo-16 ottobre 1878) a cura di Franco Valsecchi, (Roma: Istituto Poligrafico dello Stato P.V., 1976), dok. nr. 414. Notë diplomatike nga Corte për Corti-n, 11 gusht 1878. Në notë jepen edhe të dhëna mbi ndërhyrjen e personaliteteve arbëreshe pranë qeverisë italiane në mbështetje të asaj që dëftohet si “çështje kombëtare shqiptare”.

³⁴ *HSt.A.P.A.A* në *AIH*, Vj. 6-7. Ambasada e Austro-Hungarisë në Romë për baronin Zwiedinek, Romë, 2 prill 1896.

artificialisht dëshironin të riktheheshin në rrënjët e tyre.³⁵ Aspiratat që ata kishin nuk i përgjigjeshin gjendjes në të cilën ndodheshin shqiptarët, krejtësisht në kushte mesjetare. Ideali i vërtetë i tyre ishte krijimi i një “Shqipërie liberale, demokratike nën protektoratin e Italisë dhe aspak një organizim primitiv fisesh dhe ruajtjeje të privilegjeve të vjetra feudale”. Nën një analizë të tillë, diplomatët austro-hungarezë përligjnin pritshmëritë e tyre të pakta që lëvizja të jepte ndonjë efekt të thellë në hapësirën shqiptare, shtuar këtu edhe faktin se në vitin 1896 ajo konsiderohej se ndodhej ende në stadin e saj fillestar të zhvillimit socio-politik.³⁶

Thua jse të njëjtat konstatime vijojnë të përcjellin relacionet austro-hungareze edhe një vit më pas. Në raportin e datës 1 mars 1897 dërguar nga Roma për Ministrinë e Punëve të Jashtme informohej se “punët shkencore për të cilat flitet vazhdimisht, nuk e kanë parë ende dritën e botimit. Gazetat, të ashtuquajturat revista etj., janë të punuara keq, me materiale jo interesante. Prej artikujve të mbushur me fraza bombastike zbulohet një nivel kulture i ulët, objektivitet i paktë dhe një horizont i kufizuar. Për ndonjë ndikim mbi Shqipërinë vetë, këto janë ndofta të parëndësishme”.³⁷ Edhe për konsullin e Përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Theodor Ippen, propaganda e arbëreshëve nuk kishte fituar terren as në Shkodër e as në Shqipërinë e Veriut. Gazeta “La Nazione Albanese” nuk kishte parapagues të rregullt, ndërsa pak ekzemplarë të saj i dërgoheshin jo rregullisht vetëm disa personave. Duke mos përmendur politikën kufizuese të përdorur nga Porta e Lartë kundrejt gazetave të tilla, arsyet e dështimit “në shpërndarjen e shtypit arbëresh në veriun e Shqipërisë”, sipas Ippen-it, lidheshin vetëm “me përdorimin e një gjuhe të ashpër e me sharje kundër klerit”.³⁸ Kjo gjendje, nëse ishte e pasqyruar me vërtetësi nga fjalët e konsullit austro-hungarez, duket gjithsesi e kuptueshme; përderisa Italia, në gjirin e së cilës vepronin arbëreshët, nuk kishte marrëdhënie zyrtare me Selinë e Shenjtë, ndërsa kisha katolike ishte, si kudo, nën mbrojtjen e *Kultusprotektorat*-it habsburgas. Edhe në Shqipërinë e Mesme situata ishte thua jse e njëjtë. Në shkurt të vitit 1897

³⁵ *Po aty*.

³⁶ *Po aty*.

³⁷ *Po aty*, Vj. 42-3. Raport nga Roma për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Romë, 1 mars 1897.

³⁸ *Po aty*, Vj. 42-1-145. Raport i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 25 qershor 1897.

një numër i konsiderueshëm ekzemplarësh të “La Nazione Albanese”, u ishin adresuar disa fisnikëve të krishterë dhe myslimanë në Durrës, Kavajë, Tiranë, Elbasan dhe Ohër. Por, sikurse konsulli austro-hungarez në Durrës i relatonte ministrit të vet të Punëve të Jashtme, kontit Goluchowski, “i gjithë ky aksion pati një rezultat të pasuksesshëm, duke qenë se të gjithë personat e adresuar refuzuan marrjen, nga frika e komprometimit politik”.³⁹ Frika e tyre nuk ishte pa shkak, pasi pranë zyrave lokale shpejt mbërriti udhëzimi i Drejtorisë së Postave të Stambollit, me anën e të cilit Porta e Lartë ndalonte hyrjen në të gjithë territorin osman të gazetës në fjalë. Si rrjedhojë në gusht të vitit 1897, “La Nazione Albanese” e ndërpreu dërgimin e saj, duke i dhënë fund kështu të paktën për momentin, propagandës me anën e shtypit.

Një panoramë të ndryshme paraqiste ambasadori austro-hungarez në Romë, duke treguar edhe rrugën se si shtypi i arbëreshëve mbërrinte në vilajetet e Rumelisë. Në relacionin dërguar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë në maj të vitit 1897, ai bënte me dije se “në një kohë të shkurtër Lorecchio i ka krijuar shtypit kombëtar një themel të gjerë. “Stella degli Albanesi”, e botuar në Bruksel dhe fletushka e tij zyrtare “La Nazione Albanese” kanë bërë për vete 600 pajtimtarë në Shqipëri”. Gazetat e revistat, letrat si dhe artikujt, që në Bukuresht përktheheshin në gjuhën shqipe, rrallëherë ndiqnin rrugën e zakonshme postare. Sidomos ato që ishin me përmbajtje të rëndësishme politike përcilleshin me ndërmjetësinë e “ndonjë nëpunësi të konsullatës angleze në Bukuresht që ua nis kolegëve të tij zyrës në Shqipëri me vulën e hekurt angleze. Ato kalojnë në Shëngjin, Tivar e Durrës nga dora në dorë dhe në qoftë se posta nuk mund të shmanget kryekëput, atëherë përdoret një gjuhë konvencionale qoftë me fjalë qoftë me shifër”.⁴⁰ Është e vështirë të qartësohet, vetëm përmes këtij dokumentacioni, se cilat janë burimet e informacionit që ka ambasada austro-hungareze në Romë për të bërë një pohim të tillë, që bie kaq në kundërshtim me gjendjen e paraqitur nga konsujt e të njëjtit dikaster austro-hungarez nga terreni. Sidoqoftë, kjo mospërputhje të dhënash vlen si shembull specifik për të ilustruar, në një kuadër më të gjerë, përplasjen që ekzistonte në përgjithësi mbi taktikat që duhej të ndiqeshin në hapësirën shqiptare kundrejt Romës mes instancave

³⁹ *Po aty*, Vj. 42-6-684. Raport i konsullit austro-hungarez në Durrës, Winter për ministrin e Punëve të Jashtme, Durrës, 5 gusht 1897.

⁴⁰ *Po aty*, Vj. 42-6-695. Raport nga Roma për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Romë, 31 maj 1897.

të larta habsburgase (pra vetë Ministrisë së Punëve të Jashtme apo ambasadave kryesore në Romë apo Stamboll) dhe konsullatave apo zyrave më të vogla përfaqësuese të pranishme në vilajetet e Rumelisë. Interesante është se e njëjta situatë, e pothuajse i njëjti tension qendër-periferi ishte i pranishëm edhe në gjirin e shërbimit të jashtëm dhe diplomacisë italiane të asokohshme.⁴¹

Në dokumentacionin habsburgas shfaqet vëmendje edhe kundrejt përpjekjes politike të *Società nazionale albanese*, me në krye Lorecchion, me qëllim për të forcuar lidhjet kombëtare përmes krijimit të një rrjeti funksional të shoqërive të diasporës. Dokumentacioni italian na dëfton se si vetë Lorecchio mori përsipër përgjegjësinë për t'i garantuar Visconti Venosta-s hulumtimin e të gjitha mjeteve të përshtatshme për rritjen e tregtisë midis dy brigjeve të Adriatikut, e se si neglizhimi i një ndërmarrjeje të tillë nga ana e Romës mund të çonte në fuqizimin e Vjenës.⁴² Pikërisht për shkak të këtij deti që i lidhte, sipas fjalëve të Lorecchio-s, populli italian dhe ai shqiptar “nuk mund të gjykohen më si të dallueshëm dhe të ndarë njëri nga tjetri (...); që dikton detyrimin që Italia të afirmohet në fushën diplomatike, duke mbështetur së pari idenë madhore shqiptare, duke mbështetur një Shqipëri të Madhe, të madhe në kufijtë e saj natyrorë dhe historikë”.⁴³

Nuk duket pa vend shqetësimi që zgjonte *Società Nazionale Albanese* te habsburgasit. Nën veshjen me një mantel të lehtë linguistik-shkencor, sidomos pasi De Rada dhe imzot Demetrio Camarda u anashkaluan nga Lorecchio, shquheshin qëllimet e mprehta politike që shoqëria ndiqte. Duke u nisur nga konsiderata se arbëreshët kishin arritur

⁴¹ Për më gjerë mbi këtë temë, shih: Edon Qesari, “Le orme dell’egemonia italiana sul protonazionalismo albanese e lo scontro con l’alleato asburgico sull’istruzione scolastica”, *Puglia e Grande Guerra. Tra dimensione adriatica e fronte interno: fonti e ricerche*, a cura di Francesco Altamura (Lecce: Salento Books, 2017), 17-43.

⁴² Lorecchio shprehet: “Kjo Shoqëri Kombëtare Shqiptare, nëpërmjet meje, është në dispozicion të plotë të Shkëlqesisë Suaj dhe të Qeverisë Mbretërore: vetëm ne, për shkak të gjakut të përbashkët dhe për gjuhën e përbashkët me banorët e atyre trevave, jemi në gjendje t’i bëjmë shërbime tregtisë italiane në Adriatik. Ato popullata janë dyshuese në shkallën më të lartë (...) edhe ne shqiptarët do ta kemi të vështirë të depërtojmë në ato treva; me avantazhin e dukshëm të ndikimit moral, politik dhe tregtar të një fuqie tjetër, rivale dhe xheloze të Italisë”. *DDI*, Terza serie, II, 174. Mbi takimin e Lorecchio-s te Visconti Venosta, 18 gusht 1897.

⁴³ Anselmo Lorecchio, *Il pensiero politico albanese in rapporto agli interessi italiani* (Roma: Tipografia operaia romana, 1904), 88.

një shkallë relativisht të lartë kulturore, Lorecchio mendonte se “në luftërat e pritshme për lirinë e pavarësinë e Shqipërisë”, ata duhej të ishin në krye të punëve, ndërkohë që të gjitha shoqëritë në diasporë duhej të bashkëpunonin me njëra-tjetrën. Ambasadori austro-hungarez në Romë shprehte besimin se “kjo punë është në zhvillim të mbarë dhe shoqëritë e Bukureshtit, *Drita* e *Dituria*, *Société Albanaise* në Bruksel dhe ajo e Kostandinopojës do t’i përgjigjen pozitivisht ftesës”.⁴⁴ Me interes paraqitet në këtë drejtim edhe informacioni i vendosjes së lidhjeve e korrespondencës me tregtarë apo shtëpi tregtare, të njohura nga konsullatat italiane, sikurse ishin familja Summa dhe Çoba në Shkodër.⁴⁵

4. Dokumentacioni i konsultuar në shkrimin e këtij artikulli qartazi evidenton se lëvizja e arbëreshëve të Italisë shfaq tendenca nacionaliste, me prirje sidoqoftë të moderuara. Vëmendjen kryesore e merr mendimi politik i De Radës dhe A. Lorecchio-s, të cilët dallohen për diskursin e tyre të përmbajtur, ndërkohë që ai i Zef Skiroit, si mbështetës i krahu radikal/revolucionar,⁴⁶ nuk pasqyrohet. Çka dimë, në këtë drejtim, është se krahas dy lëvizjeve që u përmendën, u zhvilluan edhe të tjera, por më të dobëta dhe jetëshkurtra. Megjithatë, siç nuk mungon të vërë në dukje studiuesi D’Alessandri, faktori italo-shqiptar haste shpesh mosbesimin e bashkatdhetarëve të tyre të tej Adriatikut.⁴⁷ Veprimtaria e arbëreshëve pati bashkëpunimin e plotë të pjesës tjetër të diasporës shqiptare, përderisa puna e tyre ishte e kufizuar në sferën kulturore. Në shkëndijat e para me karakter thjesht politik, marrëdhënia mes dy brigjeve të Adriatikut u tensionua dhe u bë disi e dyshimtë.⁴⁸

Duke u kthyer te Jeronim de Rada, vlen të theksohet se ai konsiderohej nga diplomatët austro-hungarezë si njëri ndër arbëreshët më

⁴⁴ *HSt.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 42-6-695. Raport nga Roma për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Romë, 31 maj 1897.

⁴⁵ *Po aty*, Vj. 42-7-738. Raport i ambasadorit austro-hungarez në Romë, Pasetti për ministrin e Punëve të Jashtme, 31 maj 1897.

⁴⁶ Në lidhje me pikëpamjet e Zef Skiroit, shih: S. Skëndi, *Zgjimi kombëtar shqiptar 1878-1912...*, 206.

⁴⁷ A. D’Alessandri, *Gli albanesi, l’Adriatico...*, 92.

⁴⁸ Bozborra del në përfundimin se mungesa e bashkëpunimit mes shqiptarëve dhe italo-shqiptarëve buronte edhe nga identiteti fetar i të parëve, të cilët, si myslimanë, nuk do të kishin pranuar në asnjë rast ndikimin e një shteti të krishterë si Italia. E njëjta gjë do të vlente sigurisht edhe për shqiptarët ortodoksë. N. Bozborra, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar...*, 239.

përparimtarë, shumica e punimeve letrare të të cilit gjykohej se bartnin prirje politike. Ndonëse në moshë të thyer, De Rada nuk lodhej së punuari me gojë dhe me shkrim për kombin e tij, shumë më të dashur nga çdo gjë tjetër. Poezitë e tij, konferencat mbi gjuhën shqipe dhe mendimet mbi prejardhjen e shqiptarëve ishin mjaft të njohura, edhe në hapësirën shqiptare në Ballkan.⁴⁹ De Rada, dallohej për ndershmërinë, pjekurinë dhe maturinë në mendime. I pajisur me talentin e pjekur të dijetarit e të politikanit, ai e shihte çështjen shqiptare në të gjithë horizontin e saj, nga një pikëpamje shumë më e lartë se gjithë miqtë e bashkëpunëtorët e tij.⁵⁰

Në morinë e dokumentacionit të konsultuar paraqet interes një letër e De Radës, e marsit të vitit 1896. Në tërësinë e saj letra ka formën e një manifesti, që tregon udhën që shqiptarët do të duhej të ndiqnin për të arritur rezultate dhe njëkohësisht për të fituar mbështetjen e Fuqive të Mëdha. Ajo ravijëzohej nëpërmjet dy linjave: njohjes së vetes dhe marrëdhënieve të mira e të qëndrueshme me Stambollin zyrtar, i cili do të duhej t'ua njihte shqiptarëve autonominë administrative që, sipas De Radës, ia garantonte Traktati i Berlinit. Shkëputja përfundimtare do të duhej të ndodhte vetëm atëherë kur nën ndikimin e ngjarjeve të jashtme, Perandoria Osmane do të shpërbëhej. Për De Radën, shteti shqiptar do të duhej të kishte trajtën e një shteti neutral dhe kantonal sikurse Zvicra. Si një opsion i fundit, që pohon edhe ndikimin e tij nga kushtet politike në të cilat vepronte, por edhe një pavarësi e realizëm në analizën që i bënte situatës në Shqipërinë osmane, si krejt të dallueshme nga trevat arbëreshe, ai shprehej në letër: “Ne do të dëshironim të bashkoheshim në federatë me Italinë, sikurse jemi sot; shqiptarët e Greqisë (300 000 frymë) do ta shihnin ndoshta më të drejtë të lidheshin me Greqinë. Një fjalë të vjetër thonë ‘Më mirë të jesh koka e një maceje sesa bishti i luanit!’”⁵¹ Veprimtaria e shqiptarëve kishte nevojë për një përgatitje të qetë e të palodhshme, në bashkëpunim me Italinë. Ajo duhej të përqendrohej në Shqipëri, atje ku De Rada shihte edhe gjithë fushën e veprimit, ku duheshin bërë për vete elementët me më shumë influencë për çështjen e bashkimit, për konceptin e të drejtave kombëtare. Në vijim të ndjekjes së

⁴⁹ *HHSt.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 6-95. Raport i diplomatit austro-hungarez në Janinë për ministrin e Punëve të Jashtme, Janinë, 7 shkurt 1896.

⁵⁰ *Po aty*, Vj. 42-6-695. Raport nga Roma për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Romë, 31 maj 1897.

⁵¹ *Po aty*, Vj. 6-97. Letër e Jeronim de Radës (nuk e jep për kë), Macchia, 25 mars 1896.

një linje të moderuar, De Rada shprehej se: “Nevoja më imediate është që të njihemi me njëri-tjetrin... është e nevojshme që të vendosen lidhje ndërmjet mëmëdheut dhe kolonive arbëreshe që ndodhen në Itali ... I jam lutur edhe ministrit Crispi, bashkatdhetarit tonë, që këtë komunikim ta lehtësojë nëpërmjet konsujve italianë, i cili u shpreh për ndërmjetësimin e shkëmbimit të ideve me anë të shtypit kryesisht. Te shqiptarët duhet hapur, një treg për veprat e shtypura të bashkatdhetarëve të tyre në Itali, të cilët janë më të avancuar në literaturë dhe shkencë. Së afërmi do të mundohemi p.sh. të botojmë një fjalor; por qëllimi i këtij publikimi nuk do të mund të arrihet në qoftë se ky libër nuk do të blihet me shumë ekzemplarë në Shqipëri, e njëjta gjë vlen edhe për librin e gramatikës së gjuhës shqipe, ndërsa nga ana tjetër në qoftë se autorët dhe botuesit nuk paguhen për punën e tyre do ta pezullojnë botimin e këtyre librave. Më besoni se kam 10 vite që po e përpunoj këtë gjuhë, të cilën edhe e kam shtypur, gjë që u lëvdua shumë por meqë kombi im i largët nuk ka dijeni për këtë është njësoj si ‘të predikosh në shkretëtirë’ pavarësisht se me këtë unë harxhova pothuaj të gjithë pasurinë time”.⁵²

De Rada ishte realist në vlerësimet e tij sa i përket punës së bërë prej vitesh nga Austro-Hungaria, “një punë gjigande, që kishte krijuar një bazë, që deri tani më kot ishin orvatur ta trondisnin”.⁵³ Në lidhje me Italinë, ai mendonte se, “forca e saj në Shqipëri vijon të jetë e vogël”, asaj i mungonte jo vetëm propaganda e Vatikanit, që mbështeste Austro-Hungarinë, por “edhe Francën e kishte kundër vetes”. Përballë organizimit sistematik të Mbretërisë Dualiste, që hynte deri në hollësitë më të imta, politika italiane shfaqej e hutuar, e paqëndrueshme, lakmuese e nevrastenike. Në një situatë të tillë, De Rada e konsideronte me efekt pozitiv për politikën italiane faktin që “fijet kombëtare që lidhin mëmëdheun e kolonitë e saj në Kalabri nuk janë këputur por vazhdojnë të tירren më tej me këmbëngulje ...”, ndërkohë që “tregtarët e shumtë me prejardhje italiane u hapën rrugën me një orientim ekonomik këtyre momenteve të rëndësishme nga pikëpamja shpirtërore”. Çështja do çuar deri në një fund të mbarë me durim, pa nxituar, me këmbëngulje e mençuri, vijonte ai, sepse vetëm kështu “politika e Austrisë do të pësojë një dështim...” dhe “do t’i përshtatet domosdoshmërisë së hekurt të

⁵² *Po aty*.

⁵³ *Po aty*, Vj. 42-6-695. Raport nga Roma për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Romë, 31 maj 1897.

sendeve dhe me Italinë do të arrijë një mirëkuptim, një marrëveshje, që të jetë e pëlqyeshme për të dy palët”.⁵⁴

Në një linjë të moderuar mendimi dhe veprimi qëndronte edhe Anselmo Lorecchio. Filoitalianizmi i tij, qartazi më i theksuar se te De Rada - e që siç u pa më lart ka gjurmët e veta në dokumentacionin diplomatik të Romës - evidentohet dukshëm edhe në dokumentacionin austro-hungarez. Nuk kishte ekuivoke për Lorecchio-n se “ajo Fuqi që do t’u japë dorën shqiptarëve, për sigurimin e të drejtave të tyre të shenjta, do të sigurojë besnikërinë e tyre plot vetëmohim e të gatshëm për sakrificë për sa të jetë jeta, mund të jetë fare mirë Italia, sepse ajo është aleatja e natyrshme e Shqipërisë; ajo mbron tok me lirinë e bashkimit e Shqipërisë pozitën e mbizotërimit e saj në detin Adriatik, ndikimin e saj në Gadishullin Ballkanik kundrejt Austrisë dhe kundrejt mbizotërimit sllav”.⁵⁵

Ligjërimi i Lorecchio-s, në dallim nga ai i De Radës, shpërfaq hapur ndjenjat antihabsburgase.⁵⁶ Synimeve të Austro-Hungarisë kundrejt Shqipërisë ai i jepte të njëjtën peshë sikurse atyre të grekëve, bullgarëve, serbëve e malazezëve, të cilët qartazi mëtonin territoret e shqiptarëve. E destinuar për të mos qenë fuqi gjermanike, Mbretëria Dualiste, shprehej Lorecchio, aspironte të bëhej fuqi ballkanike, kryesisht në dëm të shqiptarëve, duke u bërë në këtë mënyrë unike dhe e vetme midis shteteve të Europës. Ajo nxjerr përpara shqiptarëve vezullimin plot shkëlqim të një federate, vetëm për të siguruar plotësisht skllavërimin e tyre. Mendimi i tij por edhe i anëtarëve të shoqërisë që ai përfaqësonte, kulmonin në tendencën që Austro-Hungaria duhej të përjashtohej prej hapësirës shqiptare dhe influenza e saj atje duhej të paralizohej. Kanali i Otrantos nuk duhej të zotërohej prej Habsburgasve dhe vendosja e Shqipërisë nën protektoratin e Austro-Hungarisë gjykohej si e papranueshme.⁵⁷ E informuar për të tilla mendime, në mars të vitit 1897,

⁵⁴ *Po aty*.

⁵⁵ *Po aty*.

⁵⁶ *HHSSt.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 42-5-550 Raport i ambasadorit austro-hungarez P. Passetti për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, Romë, 31 maj 1897; *po aty*, Vj. 42-544. Lidhja e dytë e relacionit dërguar nga Roma për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 17 prill 1897; *po aty*, Vj. 42-5-550. Raport nga Passetti për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Romë, 13 maj 1897.

⁵⁷ *Po aty*, Vj. 42-6-667. Përcillet në Vjenë, numri 4 i revistës “La Nazione Albanese”, 28 shkurt 1897; *po aty*, Vj. 42-3. Raport nga Roma për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Romë, 1 mars 1897; *po aty*, Vj. 42-6. Raport nga Roma për ministrin e

ambasada në Romë i kërkonte ministrit austro-hungarez të Punëve të Jashtme të vepronte. “Sado e vogël që të jetë detyra e *Società Albanese* në Corigliano Calabro, në krye të së cilës ndodhet avokati Lorecchio, mendoj se qeveria perandorake dhe mbretërore nuk duhet ta lejojë atë që të veprojë lirisht pasi mund të ndodhë me lehtësinë më të madhe që shqiptarët e nacionalizuar në Itali, të cilët ia kanë kushtuar vëmendjen e tyre mëmëdheut, të zhvillojnë aty një veprimtari të dëmshme për përhapjen e tendencave antiaustriake”.⁵⁸

Ndonëse ishte natyrë më energjike krahasuar me De Radën, diskursi i Lorecchio-s, në lidhje me veprimtarinë e shqiptarëve, i shmang kujdesshëm emocionet dhe tonet revolucionare. “Ne shqiptarët, - shprehej ai, - nuk duam të ndërhyjmë aspak në mekanizmin e forcave diplomatike. Hëpërhë luftojmë, si edhe Evropa, për integritetin e Turqisë. Udhëheqësit e partisë së veprimit shqiptar nuk mendojnë t’i krijojnë vështirësi Italisë në këtë drejtim, as dhe ta shtyjnë drejt ndërmarrjeve për të cilat ajo sot nuk është e përgatitur, as materialisht as politikisht. Ata vetëm duan që qeveria italiane të përkrahë dëshirat e tyre, sepse me ndihmën e saj ata do të mund të kryenin më mirë e më shpejt punën e tyre se sa deri tani”.⁵⁹

Veprimtaria e shqiptarëve duhej t’i shkonte për shtat ruajtjes së *status quo*-së, pozicion i cili, përveçse e vendos Lorecchio-n në një linjë me politikën zyrtare të Romës, publikisht dhe diplomatikisht e shpenzuar në mbështetje të *status quo*-së në Ballkanin osman, e njëson politikën e tij me atë që, në të njëjtën kohë, promovohet nga të tjerë krerë të parisë shqiptare, më të prirë drejt vetëvendosjes së butë dhe progresive të një Shqipërie sovrane. “Shqiptarët e dinë, - vijonte arsyetimin Lorecchio, - se *status quo*-ja, megjithëse mund të konsiderohet e urryer, megjithëse mund të mendohet si antitezë me qytetërimin modern dhe me përparimin e vazhdueshëm të popujve, sidoqoftë paraqet një garanci të tërthortë për kombësinë e tyre, e cila pa dyshim do të thithej dhe do të zhdukej në çdo ngjarje turbulluese të rendit politik aktual”. “Në një situatë të tillë, -

Punëve të Jashtme, 20 mars 1897; *po aty*, Vj. 42-6-695. Raport nga Roma për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Romë, 31 maj 1897.

⁵⁸ *Po aty*, Vj. 42-5-543. Raport nga ambasada austro-hungareze në Romë për ministrin e Punëve të Jashtme, 31 mars 1897.

⁵⁹ *Po aty*, Vj. 42-6-695. Raport nga Roma për ministrin e Punëve të Jashtme, Romë, 31 maj 1897.

përfundonte analizën ai, - lëvizja e arbëreshëve kishte si ideal më të lartë që shqiptarët t'i shihnte të afirmuar e të njohur si kombësi".⁶⁰

Në dy letra paraqitur zyrtarëve të lartë në Romë në prill të vitit 1897, në kuadrin e luftës greko-osmane, Anselmo Lorecchio, në cilësinë e presidentit të *Società Nazionale Albanese*, theksonte se shqiptarët përfaqonin parimin e kombësisë dhe do t'i kundërviheshin me armë në dorë çdo agresioni dhe çdo copëtimi të territorit të tyre. "Ata nuk dëshirojnë shkëputjen nga Turqia, por ruajtjen e *status quo*-së territoriale nëpërmjet disa reformave organizative, për realizimin e të cilave ata kërkojnë përkrahjen e Fuqive të Mëdha. Shqiptarët nuk kërkojnë protektoratin e ndonjë Fuqie dhe as aneksimin në ndonjë shtet të huaj. Përhapja e pretendimeve të tilla bëhet me qëllim keqdashës për të mbjellë farën e xhelozisë ndërmjet Fuqive të Mëdha".⁶¹

Qartazi vihej re një ndryshim në mendimin politik të Lorecchio-s, i cili sikurse edhe vetë ambasadori italian në Romë evidentonte në raportin e tij, vetëm para pak kohësh, "e paraqiste protektoratin e Italisë mbi Shqipërinë si dëshirën më të zjarrtë të këtij vendi fatkeq". Shkaku kryesor i shpejtësisë me të cilën ishte realizuar ky "s qarim i ideve", vijonte raporti, i atribuohet "këshillave të dhëna nga ana e qeverisë [italiane] që nga koha kur udhëheqësit e lëvizjes kanë krijuar kontakte më të ngushta me të".⁶² Udhëzimet dhënë delegacionit shqiptar në Romë bëheshin nën arsyetimin se shpallja dhe popullarizimi i saj në opinionin publik mund t'i krijojë Italisë vështirësi diplomatike dhe të ngjallë mosbesimin e Portës së Lartë ndaj përpjekjeve të italo-shqiptarëve.⁶³

5. Vijnë kështu tek aspekti i fundit, por jo më pak i rëndësishëm, për politikën austro-hungareze që ka të bëjë me qëndrimin e mbajtur nga Roma zyrtare në raport me lëvizjen e arbëreshëve, i cili sigurisht që ravijëzohet i ndikuar edhe nga marrëdhëniet me habsburgasit, çka në tërësinë e vet shpërfaq edhe dilemat e Fuqive të Adriatikut në lidhje me nacionalizmin e italo-shqiptarëve. Dokumentacioni i hulumtuar deri më

⁶⁰ *Po aty*, Vj. 42-6-667. A. Lorecchio, "Shqiptarë dhe grekë", *La Nazione Albanese*, nr. 4, Katanzaro, 28 shkurt 1897.

⁶¹ *Po aty*, Vj. 42-6-666. Raport nga ambasada austro-hungareze në Romë për ministrin e Punëve të Jashtme, Romë, 17 prill 1897.

⁶² *Po aty*.

⁶³ *Po aty*, Vj. 42-6-665. Raport i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Romë, M. Pasetti për ministrin e Punëve të Jashtme, 31 mars 1897.

tani nuk shfaq doza dyshimi në lidhje me qëndrimin e qeverive italiane sa i përket ruajtjes së gjendjes ekzistuese në pjesën europiane të zotërimeve osmane. Si ministri i Jashtëm Crispi, ashtu edhe pasuesi i tij Emilio Visconti Venosta i qëndrojnë besnikë ruajtjes së *status quo*-së dhe kundërshtimit të aksioneve të armatosura që mund ta vinin në rrezik atë. Të dy janë ndjekës koherentë të sigurisë dhe përlllogaritjes së interesave italianë, e kush më shumë e kush më pak, i shohin veprimtaritë arbëreshe si mjet në këtë drejtim, aspak si qëllim në vetvete. Dallimi mes tyre qëndron në faktin se Visconti Venosta është më i drejtpërdrejtë, pa peshën e prejardhjes së përbashkët, karshi arbëreshëve. Në takimin e zhvilluar me një delegacion arbëresh të kryesuar nga A. Lorecchio ministri italian do të shprehej: “Autonomia e shteteve të Ballkanit ndodhet e shkruar në flamurin e Italisë; edhe fuqitë e tjera evropiane ndjekin të njëjtin program. Për këtë arsye sapo të jenë pjekur kushtet, nuk ka dyshim që në rrugën e autonomisë së Shqipërisë nuk do të ketë pengesa. Hëpërhë, çështja në fjalë nuk është pjekur akoma. Shqiptarët duhet të jenë të bindur për dashamirësinë e Fuqive të Mëdha dhe duke pasur parasysh këtë gjë, të evitojnë çdo goditje kundër Turqisë, pasi integriteti i saj përbën sot garancinë e paqes. Para interesave të larta të paqes botërore, aspiratat e veçanta, sado të drejta qofshin këto, dalin në plan të dytë”.⁶⁴

Relacionet e diplomatëve austro-hungarezë nga kryeqendra italiane sjellin në vëmendje të eprorëve të tyre në Vjenë dallime mes politikës së ndjekur nga Crispi dhe Visconti Venosta-s. Qartazi evidentohet se Kryeministri Crispi kishte qenë aktiv sa i përket sensibilizimit të shqiptarëve për veçoritë e tyre kombëtare dhe përkrahjes së veprimtarisë së shoqërive të arbëreshëve për organizimin e mjeteve të veprimit në Shqipëri. Ai kishte nxitur një lëvizje të orientuar për krijimin e një Shqipërie të bashkuar e neutrale nën protektoratin italian, rrjedhojë kjo e frikës së tij të përhershme, por të papërligjur, se Austro-Hungaria dëshironte ta pushtonte atë.⁶⁵

Si arkitekt i realpolitikës italiane të bazuar në skemat e sigurisë kombëtare, ai e gjallëroi ndërmarrjen e tij diplomatike nëpërmjet idesë së fatit të përbashkët që ndante *Risorgimento*-ja me rilindjet e popujve të

⁶⁴ *Po aty*, Vj. 42-6-669. Raport i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Romë, M. Pasetti për ministrin e Punëve të Jashtme, 31 mars 1897.

⁶⁵ T. Toleva, *Influenca e Perandorisë Austro-Hungareze ...*, 98.

vegjël ballkanikë. Përkrahës këmbëngulës i *Raison d'Etat*, Crispi ishte gjithmonë e më i bindur se Italia duhej të ngulmonte për një epërsi të saj në Ballkan kundrejt fuqive të tjera, *in primis* pikërisht në Shqipëri.⁶⁶ Edhe pse besnik ndaj aleancës që vendi i tij kishte nënshkruar me Vjenën, ai nuk hoqi dorë nga përpjekja për të mbetur pas saj në arritjen e hegjemonisë në Ballkan. “Shkollat italiane në Shkodër, Durrës, Janinë, organizimi i veçantë politik i konsullatave italiane në qytetet e lartpërmendura, caktimi i njerëzve të besuar në Shkup, Manastir, Prizren, Durrës etj., shumat e rëndësishme që çdo vit shpenzojnë për çështjen kombëtare të Shqipërisë konsujt mbretërorë, si dhe njerëzit e tyre, të gjitha i detyroheshin aksionit të qeverisë së Francesco Crispi, shpirtin e ethshëm të të cilit, komitetet e fshehta kombëtare të Kostandinopojës, Bukureshtit, Brukselit e Lungros në çdo kohë e kujtojnë, e respektojnë si gjysmë perëndi”.⁶⁷

Me rrëzimin e kabinetit Crispi në mars të vitit 1896 dhe si pasojë e disfatës që pësoi Italia në përpjekjen e saj koloniale në Adua, në brigjet e Afrikës Lindore, veprimtaria diplomatike e Romës duket se iu rikthye vijës bashkëpunuese me aleatin e saj habsburgas dhe në lëvizjen e arbëreshëve u krijua një pauzë, e cila u evidentua edhe nga diplomatët austro-hungarezë. Broshura e parë e revistës së *Società Nazionale Albanese* u botua me vonesë, në një format të shkurtuar. Përgjatë vitit 1896 nuk u organizua ndonjë manifestim, për të motivuar interesimin e opinionit publik.⁶⁸ Duke nisur që prej këtij momenti dhe veçanërisht pasi dy Fuqitë e Adriatikut u morën vesh në Monza, politika italiane manifeston një distancë më të hapur karshi lëvizjes së arbëreshëve. Dokumentacioni austro-hungarez informonte se qeveria italiane nuk po i përgjigjej pozitivisht kërkesave për përkrahje financiare të *Società Nazionale Albanese*, për të dërguar 4-5 agjentë (si mjekë) në Shqipëri, të cilët do të vizitonin vendin, do të shpërndanin dhurata në priftërinj të caktuar si dhe në bajraktarë të disa fiseve, “shkurt, që të bënin propagandë”. Madje, relatohej edhe për mosdëshirën e ministrit Visconti

⁶⁶ E. Qesari, “Shqiponja e përçarë...”, 101.

⁶⁷ *HHSt.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 42-6-695. Raport nga ambasada në Romë për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Romë, 31 maj 1897.

⁶⁸ *Po aty*, Vj. 42-3. Raport nga ambasada në Romë për ministrin e Punëve të Jashtme, 1 mars 1897.

Venosta për të pritur një delegacion të arbëreshëve të kryesuar nga Anselmo Lorecchio.⁶⁹

Afërmendsh, Roma ishte e tërhequr nga mundësia e një zgjerimi të ndikimit italian në hapësirën shqiptare dhe kontaktet, reale apo të supozuara, të arbëreshëve me atdheun, sigurisht që shiheshin si një ndihmë në këtë kuptim. Megjithatë, edhe qeveria italiane - e cila në mënyrë shpesh të heshtur i nxiti arbëreshët duke dërguar edhe të besuarit e saj⁷⁰ - mbajti një qëndrim diplomatik thelbësisht konservator. Si Visconti Venosta ashtu edhe pasardhësi i tij, Prinetti - i cili, sidoqoftë, nuk e fshehu simpatinë e tij për lëvizjen arbëreshe - e trajtuan çështjen shqiptare brenda kuadrit të marrëveshjes verbale të Monzës, duke e ripohuar këtë të fundit edhe në vitet 1900-1901. Një njohës i vjetër i politikës së jashtme austriake të asaj kohe, von Chlumecky, nuk iu shmang përfundimit se, pavarësisht nga aktivizmi i shfrenuar i arbëreshëve, dukej qartë se ndihma e qeverisë italiane kundrejt tyre kishte pak vlerë.⁷¹ Siç shkruante edhe zëvendëskonsulli italian në Durrës, Macchioro për Lorecchio-n dhe gazetën e tij, "ai ishte i vetmi përgjegjës për veprimet e tij dhe aspak i mbështetur apo i përkrahur nga qeveria italiane".⁷² Kjo është e vërtetë edhe në qëndrimet e qeverive të ndryshme italiane ndaj politikave antiosmane që nxisnin arbëreshët, duke mos përkrahur asnjë prirje që mund të cenonte *status quo*-në zyrtare të përkrahur zyrtarisht së bashku me Vjenën.⁷³

⁶⁹ *Po aty*, Vj. 42-6. Raport nga ambasada në Romë për ministrin e Punëve të Jashtme, 20 mars 1897.

⁷⁰ *I Documenti Diplomatici Italiani*, Terza serie, vol. V (16 febbraio-31 dicembre 1901), a cura di Enrico Serra, (Roma: Istituto Poligrafico dello Stato P.V, 1979), dok. nr. 372. Konsulli italian në Janinë, Millelire drejtuar Prinetti-t, 20 maj 1901.

⁷¹ S. Skëndi, *Zgjimi kombëtar shqiptar...*, 216-217.

⁷² Sipas konsullit, madje, *Nazione Albanese* "ishte rreshtuar në llogore kundërshtare gjithashtu që shtrohej mundësia e rritjes së prestigjit italian në Shqipëri". Macchioro drejtuar konsullit të Përgjithshëm italian në Shkodër, Leoni. Shih: *I Documenti Diplomatici Italiani*, Terza serie, vol. VI (1 gennaio-30 giugno 1902) a cura di Enrico Serra, (Roma: Istituto Poligrafico dello Stato P.V, 1985), dok. nr. 493. Leoni për Prinetti-n, 13 maj 1902.

⁷³ *DDI*, Terza serie, II, dok. nr. 20. Ambasadori italian në Kostandinopojë, Pansa, për Visconti Venosta-n, 11 shtator 1897; *DDI*, Terza serie, V, dok. nr. 209. Sekretari i parë i Sulltanit për ambasadorin osman në Romë (nuk përmban datë por është arkivuar më 9 prill 1901); *DDI*, Terza serie, VI, dok. nr. 327. Prinetti për prefektin e Napolit, Tittoni, 6 prill 1902.

Me gjithë takimet dhe planet në gjirin e arbëreshëve, fakt është se asnjë nga qeveritë e Romës nuk shkoi përtej marrëveshjes së drejtpërdrejtë me Vjenën, duke anashkaluar plotësisht çdo nismë të njëanshme, e aq më tepër antihabsburgase, të prejardhur nga italo-shqiptarët apo nga ndonjë zë që vinte nga diaspora e pakufishme shqiptare. Këto pasqyrohen edhe në opinionet e shprehura disa vite më vonë prej ambasadorit të Italisë në Austro-Hungari, Nigra, i cili, si urë lidhëse midis Vjenës dhe Romës, u përpoq fort që të zvogëlonte shkallën e interesit publik në Itali ndaj çështjes shqiptare. “Në kësi kohësh, nuk them nga ana e opinionit publik, por prej qarqeve të caktuara në të dy vendet diktohet shqetësim në lidhje me të ashtuquajturën çështje shqiptare. Nga njëra anë, shqiptarët që jetojnë në Itali u përpoqën dhe po përpiqen ta ngrenë çështjen shqiptare përmes një prej gazetave të tyre, jo shumë të përhapur në të vërtetë (...) Disa gazetarë, madje edhe një deputet i Parlamentit italian udhëtuan nëpër Shqipëri dhe bënë zhurmë me raportet e tyre”. Megjithatë, pavarësisht alarmeve të herëpashershme që tronditnin dikasteret përkatëse në Vjenë dhe Romë - të yshtura sipas Nigra-s nga "llafazanëria e gazetarëve dhe e theksuar nga shfaqja në momente të caktuara të anijeve tona luftarake", si Roma dhe Vjena vazhduan të tregonin dakordësi të plotë mes tyre, të paktën për aq kohë sa *status quo*-ja nuk kishte shfaqur shenja zhbërjeje.⁷⁴

Kësisoj, duket se mendonte edhe ambasada austro-hungareze në Romë, e cila arrinte në përfundimin se në dallim nga qeveria Crispi, e cila implikohet në agjitacionin që e merrte nismën nga shoqëritë e arbëreshëve dhe të diasporës, “qeveria e sotme mban një qëndrim të ftohtë, më shumë mbrojtës gjatë kësaj lëvizjeje, ajo nuk pranon të përkrahë ato përpjekje që kanë si qëllim të shkaktojnë një agjitacion intensiv në vetë Shqipërinë. Për aq kohë sa Gadishulli Ballkanik do të preket nga kriza e burra si Viskonti Venosta dhe Rudinč do të jenë në krye të qeverisë, agjitacioni i shoqërive e shoqatave që kanë lidhje me lëvizjen do të luajë një rol të dorës së dytë”.⁷⁵ Asgjë nuk na bën të

⁷⁴ *DDI*, Terza serie, VI, dok. nr. 579. Nigra drejtuar Prinetti-t, 19 qershor 1902; *po aty*, dok. nr. 319. Konsulli i Përgjithshëm në Budapest, Cusani Confalonieri drejtuar Prinetti-t, 2 prill 1902 (në bashkëngjitje të shënimit të ambasadorit në Paris, Tornielli, drejtuar Prinetti-t, 14 prill 1902, *po aty*, dok. nr. 373). Gjithashtu, shih: E. Maserati, *Momenti della questione adriatica...*, 55.

⁷⁵ *HSt.A.P.A.A* në *AIH*, Vj. 42-6-695. Raport nga Roma për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Romë, 31 maj 1897.

dyshojmë te mprehtësia e përfundimeve austriake, të cilat duket se pohohen edhe në dokumentacionin konfidencial të kundërpalës italiane.⁷⁶ Nga ana tjetër, vihej në dukje qëndrimi dashamirës që qeveria italiane mbante ndaj lidhjeve shpirtërore që bashkonin komunitetet e lulëzuara në Itali me mëmëdheun e lashtë. Ajo me kënaqësi angazhohej të ndërmernte çdo përcapje që do të ndihmonte në zhvillimin e tyre të mëtejshëm.⁷⁷ Në këtë kontekst konsiderohej nga ambasada austro-hungareze në Romë pranimi i dy prej kërkesave të paraqitura nga Lorecchio në lidhje me bursat e studimit në Kolegjin e Shën Adrianit dhe me krijimin e një katedre të gjuhës shqipe.

Qëndrimi i qeverisë italiane kishte ngjallur zemërim te drejtuesit e lëvizjes së arbëreshëve, të cilët sikurse diplomati austro-hungarez konstatonte, e krahasojnë me kohën e Crispit dhe ankohen për pasivitetin e pasardhësve të tij.⁷⁸ Zemërimi ishte rritur edhe për një arsye të dytë, të evidentuar qartazi në dokumentacionin habsburgas, që lidhej me faktin se ata ishin të detyruar të ndryshonin qasjen e kërkesave të tyre, duke e nxjerrë në plan të dytë protektoratin e Italisë mbi Shqipërinë e ardhshme të pavarur, ndonëse kjo përbënte dëshirën e shumicës prej tyre. Ishte krijuar kështu një çarje në marrëdhëniet e arbëreshëve të përfaqësuar nga Lorecchio dhe qeverisë italiane. Kjo shprehet edhe në diskursin lutës e këshillues, por me doza kërcënimi të përdorur nga Lorecchio ndaj ministrit italian të Punëve të Jashtme: “Përkujdesuni për pavarësinë e unitetin e Shqipërisë e do të jeni përkujdesur për paqen në botë. Përndryshe keni për të parë se sa telashe do të nxjerrin si sot një vit!”⁷⁹

⁷⁶ Visconti Venosta i shkruante Nigra-s: “Kabineti i Vjenës, ashtu si kabineti i Romës, është i shqetësuar për mundësinë që pranverën e ardhshme të mund të shpërthejë ndonjë telash në provincat turke të Evropës dhe kështu paqja evropiane do të kërcënohet. Prandaj është e natyrshme të kemi dëshirën për të rënë dakord reciprokisht, nëpërmjet një shkëmbimi idesh vetëm mes nesh, për qëndrimin që duhet mbajtur në një rast të tillë (...)”. *I Documenti Diplomatici Italiani*, Terza serie, vol. I (1 - 10 marzo 1896-30 aprile 1897), a cura di Carlo Morandi, (Roma: Istituto Poligrafico dello Stato P.V, 1953), dok. nr. 383. Visconti Venosta për Nigra-n, 7 mars 1897; *po aty*, dok. 413. Ambasadori Avarna drejtuar Visconti Venosta-s, 26 prill, 1897.

⁷⁷ *HHSSt.A.P.A.A* në *AIH*, Vj. 42-6-669. Raport i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Romë, M. Pasetti për ministrin e Punëve të Jashtme, 31 mars 1897.

⁷⁸ *Po aty*, Vj. 42-6-695. Raport nga Roma për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Romë, 31 maj 1897.

⁷⁹ *Po aty*.

Përfundime

Vitet 1895-1897 konsiderohen të rëndësishme në përvijimin e institucionalizuar austro-hungarez të ndjekjes me kujdes të veprimtarisë së arbëreshëve të Italisë, kujdes që lidhej sa me jetësimin e *Aksionit për Shqipërinë*, aq edhe me përpjekjet për të arritur një kompromis në marrëdhëniet me Italinë. Informacioni diplomatik i Mbretërisë Dualiste në lidhje me veprimtarinë e arbëreshëve në këto vite është i larmishëm dhe e vë theksin në përvijimin e tipareve të lëvizjes së italo-shqiptarëve; mendimin politik të veprimtarëve të dalluar të saj, përqendruar te Jeronim de Rada dhe Anselmo Lorecchio, si edhe marrëdhënia e tyre me qeverinë italiane. Qartazi në aktivitetin e italo-shqiptarëve dallohet gërshetimi i dy tipareve: gjuhësor e letrar, si edhe politik. Ky i fundit shfaq tendenca të dukshme nacionaliste, proitaliane dhe antihabsburgase. Diskursi i veprimtarëve të dalluar arbëreshë shfaq tone të moderuara, e ndikuar edhe nga linja zyrtare e politikës italiane, e cila në vazhden e marrëveshjeve me Austro-Hungarinë i qëndroi konsekuente ruajtjes së *status quo*-së në Ballkan, si edhe mosmbështetjes së lëvizjeve të armatosura të shqiptarëve në Perandorinë Osmane.

Ledia DUSHKU, Edon QESARI

Institute of History/ Academy of Albanological Studies, Tirana
 ledia.dushku@asa.edu.al/edon.qesari@asa.edu.al

S u m m a r y

WHICH SIDE ARE THE ARBËRESH ON? HABSBURGIAN DILEMMAS TOWARD ITALIAN FOREIGN POLICY AND THE NATIONALIST STANCE OF THE ITALIAN-ALBANIAN ON THE EVE OF THE XX CENTURY

From November 17 to December 23, 1896, three secret conferences were held in Vienna under the leadership of the then Austro-Hungarian Minister of Foreign Affairs. For the Dual Monarchy, it was considered vitally important to avoid the fall of the Albanian populated areas under the Ottoman authorities

into the hands of another Great Power. Indeed, on that occasion Vienna begun to conceive of a future Albania as an independent principality under Austro-Hungarian protectorate. Meanwhile, Italy's expansionism towards the Balkans, *via* the Eastern coast of the Adriatic Sea, had clearly worried Habsburg officials. In such a context, the political activity of the Albanian-speaking minority in south Italy (called *Arbëresh*) acquired gradual importance.

This study aims to give an overview of the activities of those Italian-Albanians' activities in the period when talks were held to prepare and implement the Austrian policy in Albania. As we will see, all three stances – i.e. the Viennese arrangements to confront dynamics of the *fin de siècle* in the Balkans, the *Arbëresh* guidance of the Albanians' nationalist movement, and Rome's eastward expansionist ambitions - couldn't but be interwoven. The scenery regards the political intense years between 1895 and 1897, with developments in the Balkans and the politically and culturally ostentatious activity within the Italian-Albanian community. At the turn of the XX century, the Austro-Hungarian attention toward the *Arbëresh* movement had repercussions not only in the latter's activity, but also in the tactical communications between Rome and Vienna, partners in the same Triple Alliance. Notwithstanding both Powers' ability to leave behind mutual biases, and to adapt the self-determination bid formulated by the *Arbëresh* to their strategic joint interests, the Albanian national question movement would constitute a sort of Achilles' heel within their alliance until the crush between Vienna and Rome in the beginning of World War I.

